

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit Milagro me seli në Beograd, të cilin e përfaqëson me autorizim M.G., avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Konsoni sh.p.k. me seli në fshatin Bishtazhin të Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson me autorizim R.Gj., avokat nga Gjakova, për shkak të pagesës të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike,C.nr.582/2014,të datës 05.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.05.07.2017, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Konsoni sh.p.k. ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike, C.nr.582/2014, i datës 05.11.2015, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Milagro me seli në Beograd dhe në paragrafin I. të dispozitivit, e ka detyruar palën e paditur Konsoni sh.p.k me seli në fshatin Bishtazhin të Komunës së Gjakovës, që paditësit t`ia paguaj shumën e përgjithshme prej 32.875.40 € në emër të pagesës së borxhit të papaguar, në afatin prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Në paragrafin II të dispozitivit është detyruar pala e paditur që ti paguaj palës paditëse shumën prej 1.099.00€, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore , po ashtu në afatin kohor prej 7 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, Konsoni sh.p.k me seli në fshatin Bishtazhin të Komunës së Gjakovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen t`ia kthej Gjykatës Themelore në Prishtinë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti

## **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi Milagro me seli në Beograd, me datë 23.03.2013, ka parashtruar pranë kësaj gjykate propozimin për përmbartimin lidhur me pagesën e borxhit në shumën e përgjithshme prej 32.875.40 € ndaj palës debitore Konsoni sh.p.k me seli në fshatin Bishtazhin të Komunës së Gjakovës. Me aktvendimin e E.nr. 284/13 të dt.02.04.2013, ka lejuar përmbartimin. Debitori ka paraqitur kundërshtimin ndaj aktvendimit për lejimin e përmbartimit dhe mbi këtë bazë kjo çështje ka kaluar në procedurë kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e lëndës, fatura me nr.3026/12 e datës 08.06.2012, fatura me nr.3027/12 e datës 08.06.2012, fatura me nr.3099/12 e datës 07.09.2012, fatura me nr.3030/12 e datës 07.09.2012, fatura me nr.3032/12 e datës 24.07.2012 dhe fatura me nr.3003/12 e datës 24.07.2012, pastaj DUD me nr. 0110395 i datës 26.07.2012 si dhe me nr.0110392, DUD me nr.0110269 i datës 10.07.2012, DUD me nr.0005147 i datës 09.06.2012 dhe DUD me nr.0005149, ka gjetur se e paditura i ka mbetur borxh paditësit në shumën prej 32.875.40 €, andaj e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si ne dispozitivin e aktrgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale pasi me nenin 262 par.1 të LMD-së, është përcaktuar se: *“kreditori në marrëdhënien detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kurse debitori është i detyruar që ta përmbushë detyrimin në tërësi”*. Në rastin konkret rezulton se i padituri, duke mos e kryer detyrimin e tij që ka rrjedhur nga mallrat e pranuar i ka mbetur borxh paditësit shumën e përgjithshme prej 32.875.40 €, me ç’rast ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitori. Prandaj duke u nisur nga fakti se i padituri me mospagimin e faturave i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartë cekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie të vazhdueshme afariste për furnizim me mallra. Nga faturat e administruara si provë dhe nga DUD-at doganore të cilën përputhen plotësisht me faturat e mallrave, vërtetohet fakti se paditësja e ka furnizuar të paditurën me mallrat e specifikuar në fatura të cilat ia ka dërguar të paditurës andaj në kuptim të nenit 42 par 3 i LMD-së, andaj edhe është krijuar raporti detyrimor.

Ndërsa e paditura edhe për kundër faktit të pranimit të mallrave nuk e ka përmbushur detyrimin për pagesën e çmimit të mallrave.

Pretendimet e përfaqësuesit të së paditurës se faturat nuk janë dorëzuar te e paditura respektivisht se ato janë fiktive pasi nuk janë të nënshkruara nga personi i autorizuar i të paditurës, kjo gjykatë i konsideroi si të pabazuara sepse faturat e administruara si provë në këtë çështje juridike, përputhen plotësisht edhe me Dokumentet Doganore (DUD), nga të cilat vërtetohet qartë se paditësi e ka furnizuar të paditurën me mallra për të cilat janë lëshuar faturat kontestuese.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**  
**Ae.nr. 31/2016, dt. 05.07.2017**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tutuli,d.v.**